

RAPORT STUDIMOR

INFORMIMI, NJOFTIMI DHE KONSULTIMI PUBLIK NGA PUSHTETI VENDOR

BASHKIA FIER



QENDRA "EPOKA E RE"
QERSHOR 2022



Tabela e përmbajtjes

Hyrje.....	3
Lista e shkurtimeve	5
Profili i Bashkisë Fier	6
Metodologjia.....	8
Analizë e formave të njoftimit, informimit dhe konsultimit publik	9
Gjetjet nga anketimi me përfaqësuesit e Bashkisë Shkodër	12
Gjetjet nga anketimi me përfaqësuesit e Këshillit Bashkiak	Error! Bookmark not defined.
Konkluzione.....	25
Rekomandime	Error! Bookmark not defined.



1. HYRJE

Raporti studimor *“Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor”* realizohet në kuadër të projektit *“Përballja e Ofertave Politike – POP”*. Ajo është një nismë e rrjetit të 12 organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: *“Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social”* dhe nga National Endowment for Democracy.

Gjatë vitit 2019 janë hartuar kontratat sociale për 9 bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kamëz, Pogradec dhe Pukë) dhe që prej atij viti rrjeti *“Përballja e Ofertave Politike”* monitoron zbatimin e tyre përmes dy projekteve që shkrihen te njëri – tjetri të financuara nga Olof Plame International Centre (OPIC) dhe National Endowment for Democracy (NED).

Në vitin 2021, Rrjeti POP u zgjerua duke shtuar edhe bashkitë Elbasan, Vau i Dejës dhe Korçë. Tre Kontrata Sociale u nënshkruan në bashkitë e mësipërme duke vijuar kështu monitorimin për zbatimin e tyre në 12 bashki. Nëpërmjet këtij projekti Rrjeti POP, synon të forcojë bashkëpunimin me qytetarët në përfshirjen e tyre në vendimmarrje në nivel vendor, duke qenë një urë lidhëse mes tyre (qytetarëve) dhe pushtetit vendor për sa i përket transparencës, llogaridhënies dhe demokracisë vendore.

Organizatat e Rrjetit POP gjatë periudhës maj -qershor 2022 realizuan pyetësorë me stafet përkatëse ne Bashki dhe me përfaqësues të Këshillave Bashkiakë dhe përgjigjet e marra nga pyetësorët u përballën me analizën e bërë nga vetë shoqatat sa i përket gjendjes aktuale në secilën bashki në lidhje me menyrën se si realizohet dhe mjetet e format që bashkitë përdorin për njoftimin, informimin dhe konsultimin e publikut.

Kjo analizë tregoi që bashkitë i vlerësojnë këto procese dhe përpiqen të përdorin mjete dhe forma të ndryshme për të patur qytetarët dhe qytetaret pjesë të veprimtarisë dhe vendimmarrjes së tyre por ka dhe sfida që duhen tejkaluar e mangësi të cilat duhen përmirësuar.

Për shembull faqet zyrtare të bashkive duhet të jenë më miqësore për publikun, regjistri i kërkesë ankesave duhet të përditësohet vazhdimisht, programet e transparencës duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të konsultohen me qytetarët, bashkitë duhet të përdorin një numër të konsiderueshëm mjetesh dhe formash për njoftimin dhe informimin e qytetarëve. Proceset e konsultimeve realizohen në bashkitë pjesëmarrëse por më shumë duhet te punohet për rritjen dhe nxitjen e interesit të qytetarëve për të marrë pjesë dhe për t’u përfshirë në sa më shumë takime e dëgjesa publike, përfshirë procesin e hartimit të projekt-buxheteve.

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve rrjeti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe

llogaridhënien. Është një përpjekje për të rritur hapësirat për debate publike dhe informacione të qytetarëve në lidhje me platformat e politikave nga njëra anë dhe duke i orientuar këto platforma drejt nevojave dhe përparësive të komunitetit nga ana tjetër.



Organizatat partnere të rrjetit janë: Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” Tiranë; Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës; Qendra Rinore Vlorë; Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz; Epoka e Re, Fier; Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër; Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë; Qendra Rinore për Progres, Kukës, Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec, Gruaja në Zhvillim Korçë; Tjetër Vizion Elbasan dhe Qendra “Hapa të Lehtë” Vau i Dejës.



2. LISTA E SHKURTIMEVE

BP	Buxhetimi me Pjesëmarrje
BPGJ	Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor
KB	Këshilli Bashkiak
KKQV	Komisione Këshillimore Qytetare Vendore
GADC	Gender Alliance Development Center
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NED	National Endowment for Democracy
NJVQV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OPIC	Olof Plame International Centre
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PT	Programi i Transparencës
QV	Qeverisje Vendore
RAT	Reforma Administrativo-Territoriale



3. PROFILI I BASHKISË FIER

Që prej ndarjes territoriale si rezultat i Reformës Administrative-Territoriale në vitin 2015, Bashkia Fier përbëhet nga 10 njësi administrative (1 qytet dhe 85 fshatra): Fier, Mbrostar, Topojë, Dërmenas, Levan, Frakull, Cakran, Libofshë, Portëz dhe Qendër. Ajo ka një sipërfaqe prej 620 km² dhe një popullsi 200,376¹ banorë. Qyteti i Fierit është qendra e Bashkisë dhe Qarkut Fier dhe kufizohet me bashkitë: Divjakë, Lushnje, Patos, Mallakastër, Selenicë dhe Vlorë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Fierit.

Bashkia e Fierit shtrihet në pjesën qendrore - perëndimore të Shqipërisë. Ajo gëzon një pozitë të favorshme gjeografike dhe strategjike. Në të kalojnë dy nga korridoret më të rëndësishme të vendit: Korridori VIII dhe Korridori i Kaltër (autostrada Adriatiko-Joniane). Bashkia Fier përfshin disa nga zonat bujqësore më të rëndësishme të vendit, si dhe një pjesë të konsiderueshme të industrisë që lidhet me përpunimin e naftës. Kufizohet nga dy lumenj kryesor, Semani dhe Vjosa, të cilët kanë sipërfaqe të mbrojtura natyrore pranë grykëderdhjeve të tyre; zotëron parkun arkeologjik kombëtar të Apolonisë; trashëgon zona industriale dhe naftëmbajtëse si dhe gëzon pozicionim strategjik avantazhues përse i përket gazifikimit të mundshëm, me vënien në zbatim të gazsjellësit TAP që kalon brenda territorit të saj².

Në territorin e Bashkisë gjenden toka shumë pjellore. Më shumë se 55 % e popullsisë së bashkisë jeton në zonat rurale, gjë që tregon rëndësinë e sektorit të bujqësisë në jetën ekonomike. Prodhimi bujqësor është i shumëllojshëm nga drithi te zarzavatet, bostanoret, blegtoria dhe nënproduktet e saj.

Shfrytëzimi i bregdetit për turizëm është ende në fillesat e veta. Njësitë administrative Topojë dhe Dërmenas kanë një vijë bregdetare ranore prej 30 kilometrash, e gjitha shumë e përshtatshme për turizmin familjar. Vlerësohet se rreth 10 mijë vetë në vit zgjedhin këtë vijë bregdetare për pushime verore, kryesisht afatshkurtra.

Zhvillimi i Bashkisë Fier udhëhiqet nga parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe ka në fokus mirëqenien ekonomike dhe sociale të qytetarëve të saj, mbështetur në një mjedis të shëndetshëm dhe me aftësi vetë-ripërtëritëse. Koncepti i zhvillimit të Fierit shkon përtej atij ekonomik, duke synuar gjithmonë e më tepër që ky i fundit të harmonizohet me mbrojtjen e burimeve natyrore, zbutjen e kontrasteve sociale dhe promovimin e zhvillimit intelektual.

¹ Burimi: Ministria e Brendshme, Regjistri i Gjendjes Civile viti 2016.

² Burimi: Dokumenti i Strategjisë së Zhvillimit të Territorit 2016



Një nga objektivat kryesor të Bashkisë Fier është konsolidimi i profilit të saj si pol i zhvillimit ekonomik rajonal, përmes diversifikimit të ekonomisë dhe krijimit të kushteve për rritjen e konkurrueshmërisë në nivel vendi dhe më gjerë. Misioni i Bashkisë në funksion të realizimit të vizionit strategjik të zhvillimit është vënia në dispozicion në mënyrë inteligjente e të gjitha burimeve financiare e njerëzore për harmonizimin e interesave për zhvillim ekonomik e social në të gjithë territorin e Bashkisë.

Bashkia ka hartuar projekt buxhetin afatmesëm për tre vitet e ardhshme 2022 – 2024. Bashkia ofron një buxhet realist dhe të ekuilibruar. Administrimi i Bashkisë, shërbime publike vendore, arsimit bazë dhe parashkollor, menaxhimi i mbetjeve dhe trashëgimia kulturore zënë peshën më të madhe në financimin e buxhetit të bashkisë për tre vitet e ardhshme.

Hartimi i projekt buxheteve kalon përmes proceseve konsultuese me qytetarët. Si rezultat i kësaj, projekt buxhetet tentojnë t'i përgjigjen nevojave të komunitetit, duke qenë se në to reflektohen një pjesë e konsiderueshme e rekomandimeve të mbledhura nga procesi i konsultimit.

Transparenca mbetet ende një sfidë për Bashkinë Fier. Bazuar në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, dhe ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, transparenca, përfshirë informimin publik janë shërbime që do t’u ofrohen qytetarëve edhe nëpërmjet fuqizimit të sistemit elektronik, siç janë rrjetet sociale dhe faqja zyrtare web e Bashkisë. Kjo e fundit ka qenë përherë një problematikë për bashkinë Fier, që me sa duket do të marrë zgjidhje deri në vjeshtë.

Për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve në bashkinë Fier shërbejnë sportelet e Zyrës me Një Ndalesë, një shërbim që funksionon për më shumë se 10 vite dhe që ka garantuar cilësi shërbimi në një kohë më të shkurtër e produktive.



4. METODOLOGJIA

Për hartimin e raportit mbi situatën e informimit, njoftimit dhe konsultimit publik në Bashkinë Fier janë kërkuar dhe përdorur një seri teknikash dhe instrumentash, të tilla si: a) hartimi i metodologjisë dhe instrumentit të anketimit (dy pyetësorë); b) kërkim dhe analizim të informacionit, dokumentave (fizikë dhe elektronikë) dhe kuadrit rregullator e ligjor përkatës; c) intervista të thelluara me stafin e bashkisë dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak; d) analizim dhe përpunim të të dhënave të anketimit dhe e) përgatitja e raportit së bashku me rekomandimet përkatëse.

Ekspertët e projektit e bazuan procesin e kërkimit dhe analizimit në tërësinë e informacionit dokumentacionit dhe praktikave, të përdorura në procese të ndryshme të njoftimit, informimit, konsultimit dhe angazhimit të komunitetit në bashkëqeverisje dhe vendimarrje. Procesi i kërkimit dhe analizimit u shtri si në dokumencionin ekzistues zyrtar, ashtu edhe në kuadrin respektiv rregullator e ligjor, të tilla si Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, etj. Identifikimi dhe analiza e burimeve ekzistuese tregoi se ka pak informacion dhe të dhëna të disonueshme mbi praktikën e përfshirjes qytetare në qeverisjen vendore.

Pamjaftueshmëria e informacionit të disponueshëm mbi çështjen në fjalë, theksoi rëndësinë e procesit të anketimit me të gjithë hallkat e veta (hartimi i metodologjisë, përcaktimi i rubrikave dhe informacionit që duhej mbledhur dhe analizuar, dhe format e mjetet që do të përdoren për kryerjen e tij). Metoda kryesore për realizimin e studimit është ajo sasiore, që nënkupton përdorimin e pyetësorëve për mbledhjen e të dhënave. Anketimi përdori gjerësisht elemente të vlerësimit cilësor nëpërmjet pyetjeve të hapura dhe shpjeguese me qëllim eksplorimin e instrumenteve dhe proceseve që sigurojnë angazhim dhe gjithë përfshirje të komuniteteve në pushtetin vendor. Metodologjia e studimit mbart elementë të fortë të vlerësimit informativ.

Pjesë e këtij anketimit janë drejtues, stafe teknike dhe këshilltarë vendorë të 12 bashkive të madhësive të ndryshme të përfshira në programet shumë vjeçare që Olof Palme ka zbatuar në vend. Për anketimin u hartuan dy pyetësorë me pyetje shteruese cilësore dhe sasiore, të cilat mbulojnë një gamë të gjerë temash dhe çështjesh. Për përgatitjen e pyetësorëve u konsultuan paraprakisht ligjet, rregulloret dhe udhëzimet përkatëse që përbëjnë kuadrin ligjor dhe institucional mbi informimin, njoftimin dhe konsultimin qytetar në nivel vendor.

Faza përmblyëse përfshiu hedhjen, përpunimin statistikor, studimin dhe analizimin e të dhënave, si dhe përgatitjen e këtij raportit përfundimtar.

5. ANALIZË E FORMAVE TË NJOFTIMIT, INFORMIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK

Transparenca në qeverisje është element kyç në mbarëvajtjen e proceseve në nivel lokal dhe kombëtar, por mbi të gjitha është domethënëse përsa i përket besimit qytetar. Transparenca konsiderohet si baza e qeverisjes së mirë dhe komuniteteve të fuqishme që dinë çfarë kanë, çfarë duan dhe si të veprojnë. Thelbësore e vlerave të transparencës është se përveçse ajo lufton korrupsionin, rrit edhe besimin e qytetarëve.

Transparenca, edhe pse shihet me vëmendje dhe ka përpjekje serioze nga Bashkia Fier për realizimin e saj në gjithë fushat e aktivitetit të saj, përsëri ka nevojë për përmirësim në disa elementë kryesisht teknike dhe aplikimin e metodave të reja të suksesshme, duke shtuar se nuk mungon vullneti për ta bërë këtë.

Një nga problematikat që ka penalizuar Bashkinë Fier në këtë mision është faqja zyrtare online, e cila prej disa muajsh nuk funksionon për arsye teknike. Ky është një shqetësim i ardhur edhe nga vetë përfaqësuesit e Bashkisë, të cilët kanë nisur nga puna për ndërtimin e një tjetër faqeje, me qëllim dhënien e mundësisë dhe aksesit të përditësimit dhe informimit të qytetarëve. Mungesa e një modeli të unifikuar gjithashtu e vështirëson gjetjen e informacionit për qytetarët, të cilët nuk mund të orientohen shumë mirë në faqet web.


Përveç problematikës teknike të mungesës së aksesit, një tjetër shqetësim që e kanë shprehur vazhdimisht edhe përfaqësuesit e institucionit, ka qenë dhe organizimi jo i mirë i faqes aktuale. Megjithatë, pavarësisht ngërçit teknik që cënon përditësimin e informacioneve, Programi i Transparencës është i publikuar në formën dhe mënyrën e udhëzimeve të përcaktuara në ligj.




Përsa i përket praktikave të kahershme të infomimit të tilla si: publikimet fizike dhe infomimi i drejtëpërdrejtë në rrjetet sociale apo media audiovizive, Bashkia përdor të gjitha mënyrat për të shpërndarë njoftimet me interes publik si online ashtu edhe shpallje në vende me akses të gjerë.

Shpërndarja e informacionit bëhet nëpërmjet **faqes zyrtare të Bashkisë** <http://bashkiafier.gov.al/> (sot ajo nuk përditësohet për arsye teknike të përmendura më sipër dhe po punohet për një krijimin e një web të ri dhe funksional);

- Për të njëjtin qëllim shërbën edhe **faqja zyrtare e Facebook e Bashkisë** <https://www.facebook.com/bashkia.efierit/>, si dhe **faqja zyrtare e Facebook e Këshillit Bashkiak** <https://www.facebook.com/K%C3%ABshilli-Bashkiak-Fier-104337948185698>.
- **Kërkesat e qytetarëve**, në masë vazhdojnë të bëhen në mënyrën klasike (me shkresë nëpërmjet Koordinatorit të Informimit) në **sportelet e Zyrës me Një Ndalesë**. Një pjesë e tyre nëpërmjet postës elektronike info@bashkiafier.gov.al dhe një pjesë e vogël, kryesisht ato me karakter institucional, nëpërmjet postës shqiptare.
- **Ankesat** masivisht adresohen nëpërmjet **postës elektronike (inbox) të FB të bashkisë** <https://www.facebook.com/bashkia.efierit/>, ose **në e-mail**, por dhe pse në përqindje të vogël **vazhdojnë ankesat me shkrim drejtuar Kryetarit të Bashkisë**.
- Edhe pse **në cdo godinë të njësive administrative** është vendosur një **kuti për mbledhjen e ankesave të qytetarëve**, nuk ka ndonjë rezultat të kthimit të kësaj mënyre në praktikë. Besimi i vakët i qytetarëve karshi vlerësimit të mendimit apo ankesës së tyre ka bërë që kjo praktikë të mos funksionojë siç duhet.
- Këtë vit ka funksionuar edhe një dritare tjetër për informim, ajo e Këshillit Bashkiak Fier. Kjo faqe e hapur në FB krahas dritares në Web ka qenë një mundësi për t'u ofruar qytetarëve informacione dhe njoftime në një kohë më të shkurtër dhe më të lehtë. Kërkesat, ankesat, apo aplikimet e drejtëpërdrejta kanë një rezultat më të mirë në lidhje me përmbushjen e afateve ligjore deri në rikthimin tek burimi. Kjo për faktin se të gjithë rrugën, nga burimi (përpiluesi i kërkesës/ankesës/aplikimit) e përshkon koordinatori i informimit me përgjegjësinë për ta reflektuar atë në regjistrin elektronik.



- **Koordinatori i Njoftimit dhe Konsultimit Publik** është një pozicion i mbivendosur. Këtë funksion e kryen një specialist me ngarkesë tjetër funksionale.



- **Publikimi online i njoftimeve është më i shpejtë dhe masivisht i përdorshëm** nga Bashkia Fier, duke e parë si një mënyrë të shpejtë të shpërndarjes së informacionit. Megjithatë, **shpallja e tyre në vendet me akses të gjerë mbetet forma zyrtare e aplikuar dhe e parapëlqyer nga qytetarët. Njoftimet me interes edhe për banorët e zonave rurale afishohen edhe në ambientet e NJA-ve si dhe në ambiente me akses të lartë në zonë.**
- **Mënyra më e mirë e njoftimeve, kryesisht për dëgjesat publike** nga ana e Bashkisë por dhe e Këshillit Bashkiak **shihet publikimi në rrjetet sociale.** Nëpërmjet tyre shpërndahet informacioni më mirë dhe në kohë më të shpejtë duke qenë se pothuajse të gjithë kanë një llogari në FB.
- **Problematike mbetet pjesëmarrja e qytetarëve në dëgjesa publike.** Edhe pse njoftimet bëhen në disa mënyra prezenca qytetare ndihet ende pak. Kjo jo për faktin e mungesës së informacionit por të indiferencës që ekziston në shoqëri ndaj këtyre proceseve.
- **Takimet e drejtëpërdrejta dhe komunikimi me Kryetarin** shihen nga qytetarët si më të efektshme dhe mënyra më e përdorshme edhe sot. Kjo mënyrë duket se u jep më siguri qytetarëve për adresimin e problemit dhe besim për zgjidhjen e tij.
- **Dëgjesat publike** janë një praktikë që Bashkia Fier e realizon në mënyrë permanente gjatë hartimit të buxhetit vjetor dhe atij afatmesëm, sikurse dhe projekteve infratrakturore dhe ato me ndikim në komunitet.

6. GJETJET NGA ANKETIMI ME PËRFAQËSUESIT E BASHKISË FIER


Kuadri ligjor në fuqi parashikon një sërë detyrimesh dhe përgjegjësishë në lidhje me format dhe mjetet që institucionet publike duhet të venë në dispozicion të mundësimit të pjesëmarrjes së publikut dhe grupeve të interesit në procesin e informimit, njoftimit dhe përfshirjes së tyre në konsultim e vendimarrje.

Për të parë ecurinë e këtyre proceseve në respekt edhe detyrim të ligjit dhe qytetarëve, u zhvillua një anketim me x përfaqësues të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak Fier. Anketimi synon të evidentojë dhe sjellë në vëmendje situatën aktuale të pjesëmarrjes qytetare në proceset konsultuese dhe vendimmarrëse si dhe të analizojë të gjitha format dhe instrumentat që institucioni i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak përdorin për sjelljen më pranë të qytetarëve në bashkëqeverisje.

Shtatë të intervistuarit nga institucioni i Bashkisë mbulojnë pozicione kyçe në realizimin e detyrave dhe proceseve që lidhen me qytetarët (qoftë edhe jo drejtpërdrejtë), të tilla si: Zv/kryetar bashkie, koordinator infomimi, specialistë të kabinetit, IT, specialitë promovimi, përfshi edhe menaxhues administrativ (administratorë njësie).


Njoftimi, Informimi dhe Konsultimi në Vendimmarrjen Vendore


Pyetjes mbi rëndësinë e njoftimit në vendimmarrjen vendore 71% të intervistuar punonjës të institucionit të Bashkisë Fier i janë përgjigjur “shumë i rëndësishëm”, kurse 29% kanë pohuar se është “i rëndësishëm”.



Kuadri Ligjor për Njoftimin, Informimin dhe Konsultimin në Nivel Vendor

Përsa i përket njohurive të të intervistuarve mbi ligjin për njoftimin, informimin dhe konsultimin në vendimmarrjen vendore vetëm 28.5% kanë deklaruar se e njohin shumë mirë atë. 43% e njohin mirë dhe 28.5% prej të intervistuarve e kishin pak njohuri mbi bazën ligjore.





Në lidhje me vlerësimin e kuadrit ligjor mbi njoftimin dhe informimin e publikut në nivel vendor mendimet kanë qenë të shpërndara: 43% kanë pohuar se kuadri ligjor është i qartë dhe i plotë; 28.5% të intervistuarit janë shprehur se ai është i qartë por jo i plotë dhe 28.5% kanë pohuar se është i paqartë dhe jo i plotë.

Edhe pse 4 të intervistuar kanë reflektuar paqartësi të ligjit apo nevojën për rishikim të tij, nuk kanë dhënë një opinion në lidhje me sugjerimet e nevojshme. Një prej të intervistuarve ka thënë se:


“Është e nevojshme qartësim më i plotë i dokumentave të klasifikuara si dokumenta që nuk publikohen pa kërkesë dhe qartësim të informacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Një tjetër ka theksuar faktin se ligji do të ishte i plotë dhe i qartë nëse do të bëhen rregulimet që po diskutohen aktualisht dhe pritet të ketë reflektim së shpejti.

“Ligji do të ishte i plotë dhe i qartë nëse do të bëhen rregulimet që po diskutohen aktualisht dhe pritet të ketë reflektim së shpejti”.

Pjesa tjetër e të intervistuarve nuk kanë dhënë asnjë mendim duke kërkuar më shumë kohë për të menduar në lidhje me rishikimin e ligjit, ose duke u shprehur se duhet thjesht zbatim më i mirë i tij.


Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik




Në Bashkinë Fier ka një Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, por ky nuk është i vetmi pozicion që mbulon. Përveç detyrave që ka në lidhje me median dhe marrëdhëniet me publikun, përmbush edhe pozicionin e Koordinatorit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik. Ekzistenca e Koordinatorit njihet nga të gjithë të intervistuarit, si edhe profilet e punës që realizohen prej tij.

Koordinatori për të Drejtën e Informimit

Përsa i përket Koordinatorit për të Drejtën e Informimit ai është i njëjtë me Koordinatorin e Transparencës. Duke patur emërtesa të ndryshme, dy prej të intervistuarve janë shprehur se: “Kemi koordinator të informimit dhe njoftimit, por jo të transparencës.”




Informacioni rreth ekzistencës së këtyre dy pozicioneve shumë të rëndësishme në Bashkinë Fier që lidhen direkt me qytetarët për informimin dhe njoftimin e tyre janë të publikuara në faqen zyrtare të Bashkisë, bashkë me mënyrat e kontaktit.



Instrumentat për njoftimin e qytetarëve

Bashkia Fier përdor mjete të ndryshme për të njoftuar dhe informuar qytetarët, përfshirë mediat lokale, revistën që ajo e prodhon si institucion, afishimin e njoftimeve dhe informacioneve në vende me akses të gjerë, komunikimet e drejtëpërdrejta, etj. Mënyra më e përdorshme është përdorimi i rrjeteve sociale si mënyra më e mirë e depërtimit të informacionit dhe njoftimit tek qytetarët. Bazuar në përgjigjet e të intervistuarve, format e ndarjes së informacionit me qytetarët realizohen nëpërmjet:

- Lajmërimin publik afishuar në ambjentet e bashkisë (85.7%)
- Lajmërimin në mediat audio-vizive lokale (57.1%)
- Lajmërimin në mediat sociale (Facebook, etj) (100%)
- Lajmërimin individuale përmes postës (0%)
- Lajmërimin individuale përmes postës elektronike (0%)
- Lajmërimin publik afishuar në ambjentet e NjA-ve, qendrave urbane (14.2%)
- Lajmërim individual nga kryetarët e fshatrave, administratorëve (14.2%)
- Lajmërimet e drejtëpërdrejta me qytetarët, biznesin, OJF (42.8%)



Regjistri Elektronik

Pavarësisht problematikës me faqen e web, Bashkia Fier ka të publikuar Regjistrin Elektronik me të gjitha fushat specifike të plotësuara dhe të përditësuar. Nga monitorimi i bërë rezulton se Regjistri pasqyron të gjitha kërkesat e ardhura në rrugë elektronike, nëpërmjet Postës Shqiptare, si dhe kërkesat e plotësuara në sportelet e Zyrës me Një Ndalesë.

Regjistri pasqyron kohën e procesit që i duhet një kërkesë/ankese nga momenti i protokollimit deri në dorëzim tek burimi, si dhe përgjigjen e secilës prej tyre, në bazë të kriterëve të përcaktuara në Ligjin për të Drejtën për Informim. Nga anketimet e kryera rezulton se të gjithë kanë dijeni për Regjistrin Elektronik.



Mjetet e Informimit të Qytetarëve

Bashkia përdor të gjitha mënyrat për të shpërndarë njoftimet me interes publik:



- Shpallje në vende me akses të gjerë, afishim në ambientet e Bashkisë dhe kryesisht në standat e Zyrës me Një Ndalesë, ambientet e NjA-ve, etj.

- Publikim dhe shpërndarje e informacionit nëpërmjet faqes zyrtare të Bashkisë <http://bashkiafier.gov.al/> ; FB-

<https://www.facebook.com/bashkia.efierit/>.

- Njoftime dhe pasqyrime informacioni në mediat audio-vizive lokale.
- Publikim në revistën e institucionit
- Shpërndarje informacioni në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe individuale. Kjo praktikë e përdorur kryesisht në zonat rurale, ku dhe aksesit me informacionet online, median dhe vizitat në institucione është më i vogël.

Bazuar në përgjigjet e të anketuarve, por edhe nga monitorimi i bërë rezulton se mënyrat më të përdorshme nga Bashkia Fier për shpërndarjen e informacionit janë:



- Afishimet publike në Zyrat me Një Ndalesë (100%);
- Publikimet në faqen zyrtare të Bashkisë (100%), për të cilën ka rezerva për përditësim informacioni nga monitorimet e bëra për shkak të problemeve teknike;
- Publikim në mediat sociale (100%);
- Publikimet në këndet e informimit në ambientet e Bashkisë/NJA (85.7%);
- Regjistri elektronik (71.4%);
- Mediat audio-vizive lokale (71.4%);
- Botimet e bashkisë (57.1%);
- Materiale informuese (fletë palosje, etj) (57.1%).

Aksesi në Dokumentat dhe Informacionin Zyrtar

Ligji 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” iu garanton qytetarëve akses në dokumentet zyrtare përmes vënies në dispozicion të informacionit nga institucionet shtetërore.



Referuar pyetjes: “A kanë mundësi qytetarët të marrin apo aksesojnë lehtësisht dokumenta dhe/apo informacione që ju duhen pranë bashkisë?”; Nga monitorimet e bëra, por dhe nga anketimet, rezulton se qytetarët kanë akses 100% për të marrë informacione të ndryshme, dokumenta apo adresojnë një problematikë. Zyra me Një Ndalesë është një burim i mirë informacioni, si

për mënyrën e ndjekjes së procedurave, dokumentacioneve, praktikave të ndryshme, ashtu edhe për informacione të ndryshme që lidhen me institucionin e bashkisë. Burim informacioni është edhe faja zyrtare e Bashkisë, por më aktive është faja zyrtare Facebook e Bashkisë. Në këtë të fundit ka dhe interaktivitet me qytetarët të cilët e shohin dhe si mënyrë të mirë për të adresuar problematika, ankesa, sugjerime apo ankesa.

Publikimi dhe Afishimi i Akteve të Bashkisë

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, transparenca, përfshirë informimin publik janë shërbime që do t’u ofrohen qytetarëve edhe nëpërmjet fuqizimit të sistemit elektronik siç janë rrjetet sociale dhe Web. Kjo e fundit ka qenë përherë një problematikë për Bashkinë Fier, që me sa duket do të marrë zgjidhje deri në vjeshtë.



Megjithatë, nga monitorimi i faqes zyrtare ekzistojnë të publikuara akte të Bashkisë, por struktura e vetë kësaj faqeje nuk të jep shumë qartësi në rrugën e kërkimit të informacionit, një nga arsyet kjo që Bashkia Fier po punon për të ndryshuar edhe strukturën e faqes. Nga anketimet është pohuar publikimi dhe afishimi i tyre në masën 100%, gjë që është konstatuar edhe nga monitorimi i bërë.


Programi i Transparencës

Që nga viti 2018, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar një model të Programit të Transparencës. Ligji 119/2014 “Për të





Drejten e Informimit” detyron të gjitha institucionet publike të publikojnë Programin e Transparencës në faqen e tyre zyrtare të internetit. Siç u shpjegua më sipër, për arsye të problemeve teknike, Programi i Transparencës është i publikuar në formën dhe mënyrën e udhëzimeve të përcaktuara nga ligji dhe ka disa raporte monitorimi të publikuara. Gjithsesi, për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve në Bashkinë Fier shërbejnë sportelet

e Zyrës me Një Ndalesë, një shërbim që funksionon për më shumë se 10 vite dhe që ka garantuar cilësi shërbimi në një kohë më të shkurtër e produktive. Anketuesit u përgjigjën në masën 86% për ekzistencën e këtij programi dhe publikimin e tij dhe 14% që nuk kanë informacion.



Në lidhje me hartimin dhe/apo publikimin e raporteve vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes, të anketurit kanë qenë të lëkundur me përgjigjet e tyre. Shumë prej tyre shprehen se PT është i plotë dhe publikohet, por nuk kanë informacion për raporte vjetore nëse bëhet fjalë për informacion narrativ që duhet plotësuar dhe publikuar. Për këtë ata janë shprehur në mënyrë evazive: 14% jo, 42% nuk kam informacion, 30% po, 14% nuk e kam të qartë.



Përsa i përket informacionit që përfshihet në të mbi: numrin e akteve të miratuara nga Bashkia përgjat vitit referues, numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara, numrin e rekomandimeve e të

komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes si dhe numrin e takimeve publike të organizuara, anketuesit janë shprehur respektivisht: 29% i përmban

të gjitha; 43% nuk kam informacion; 14% numrin e akteve të miratuara nga Bashkia përgjatë vitit dhe 14% janë shprehur se përmban numrin e akteve të miratuara nga Bashkia përgjatë vitit, numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara dhe numrin e takimeve publike të organizuara. Nga monitorimi i faqes së web nuk rezultojnë të ketë të publikuara akte të miratuara përveç buxheteve (vjetore dhe afatmesme), vendimeve të Këshillit Bashkiak, apo rekomandime.


Në lidhje me sfidat dhe vështirësitë që janë ndeshur për njoftimin dhe informimin e publikut, të intervistuarit përgjithësisht kanë dhënë opinione të ndryshme. Vetëm 14% kanë deklaruar se nuk është në profilin e tij të punës. Sfidat dhe vështirësitë e skeduar janë:

- Problematika me faqen zyrtare të bashkisë;
- Indiferentizmi i opinionit publik;
- Ndërgjegjësimi i qytetarëve;
- Pargjykimet mbi procesin;

Përsa i përket rekomandimeve, ato renditen si më poshtë:

- Standardizimi i faqes zyrtare (web) në mënyrë që çdo qytetar, kudo qoftë ai të di ku të kërkojë informacionet. Nëse faqet kanë të njëjtin model dhe strukturë përmbajtësore kushdo të hyjë në të e di ku të kërkojë informacionin si në faqen e bashkisë Fier, Tiranë, Shkodër, Vlorë, etj. Në këtë mënyrë nxitet përgjegjshmëria, llogaridhënia dhe transparenca.
- Sa më shumë trajnime dhe fushata ndërgjegjësuese mbi të drejtën e informimit.
- Përmirësimi i bazës ligjore të së drejtës së informimit mbi ato çështje që po diskutohen aktualisht

Trajnime për Kuadrin Ligjor të Informimit, Njoftimit dhe Konsultimit Publik




Referuar anketimit vetëm 14% e të anketuarve janë shprehur se kanë marrë pjesë në trajnime mbi detyrimet ligjore për informimin publik. 86% janë shprehur se nuk kanë marrë pjesë asnjëherë. Ndërkohë, 14% e të intervistuarve janë shprehur se nuk kanë interes në lidhje me trajnimet për informimin publik, njoftimin dhe konsultimin. 14% kanë interes për këtë tematikë dhe

72% e tyre janë shprehur se janë të gatshëm të marrin pjesë në çdo trajnim të mundshëm, pasi e shohin si një mundësi për të përmirësuar veten, proceset informuese dhe teknike në institucion, si dhe punën e tyre të përditshme.

GJETJET NGA ANKETIMET ME PËRFAQËSUES TË KËSHILLIT BASHKIAK FIER

Pjesë e anketimit ishin edhe shtatë anëtarë të Këshillit Bashkiak Fier. Për të patur një balancë në opinionin e marrë si nga ana e Bashkisë ashtu edhe nga Këshilli Bashkiak është marrë i njëjti numër anketuesish. Për të sjell diversitet dhe cilësi mendimi janë targetuar pozicionet si më poshtë: Sekretari i KB; personi që arshivon procesverat e KB; Kryetar i komisionit të Ekonomisë, Financës dhe Privatizimeve; Kryetar i Komisionit të Çështjeve Sociale dhe atij Juridik e Institucional; Kryetar i Komisionit për Punët Publike dhe Emergjencat dhe Kryetari i Komisionit të Arsimit dhe Sportit. Në këtë mënyrë i gjithë informacioni i marrë është i shpërndarë në të gjithë strukturat e këshillit, duke vjelë kështu njëkohësisht edhe propabilitetin e njohurive dhe ndikimit të procesit të informimit.


Njoftimi, Informimi dhe Konsultimi në Vendimmarrjen Vendore




Duket se këshilltarët vendorë i gjejnë kryesisht të rëndësishme proceset e informimit, njoftimit dhe konsultimit me qytetarët. Në lidhje me pyetjen se sa i rëndësishëm është njoftimi, informimi dhe konsultimi në vendimmarrjen vendore. 86% e anketuesve janë shprehur se është shumë i rëndësishëm dhe 14% i rëndësishëm.

Baza ligjore për njoftimin, informimin dhe konsultimin në nivel vendor

Niveli i njohjes së bazës ligjore mes anketuesve të Këshillit Bashkiak Fier ka lënë hapësirë për më shumë përqendrim në këtë aspekt. 28.5% e të anketuarve janë shprehur se njohin shumë mirë ligjin për njoftimin, informimin dhe konsultimin, 28.5% e njohin disi dhe 43% e njohin mirë.




Pavarësisht nivelit të njohjes së bazës ligjore



vlerësimi për cilësinë e tij dhe qartësinë nga ana e anketuesve të KB Fier është në nivelin:

- i qartë dhe i plotë 57%
- i paqartë por i plotë 29%
- i paqartë dhe i paplotë 15%

Rregulloret e Këshillit Bashkiak





Në lidhje me ekzistencën dhe njohjen e rregulloreve të KB, ata janë shprehur:

- 14% ka rregullore pa e specifikuar çfare.
- 43% njohin Rregulloren për Marrëdhëniet me Publikun dhe Media;
- 57% njohin Rregullore për Ankesat Kërkesat Peticionet Iniciativa
- 28% nuk e dinë nëse ka rregullore;
- 14% nuk ka rregullore;

Lidhur me vlerësimin mbi rregulloret e KB këshilltarët që u shprehën mbi ekzistencën e rregulloreve për Marrëdhënjet e KB me publikun dhe median dhe atë të shqyrtimit të ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare ndanë mendime të ndryshme: 43% të qarta dhe të plota; 43% të paqarta dhe jo të plota; 14% të paqarta, por të plota.

Vlerësimi i rregulloreve të KB-së Fier



Qartësia dhe njohja e rregulloreve të KB në përgjithësi dhe në mënyrë specifike Rregulloreve për Marrëdhënjet e KB me publikun dhe median, si dhe asaj të Shqyrtimit të Ankesave, Vërejtjeve, Kërkesave, Peticioneve dhe Iniciativave Qytetare përbënin pothuajse masivisht rekomandimet nga anketuesit në këtë drejtim.

Bashkëpunimi mes Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak


Bashkëpunimi mes Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak Fier është perceptuar nga të gjithë të anketuarit shumë i mirë dhe gjithmonë i frytshëm. Ata janë shprehur se këto bashkëpunime ndihen më shumë në proceset e dëgjësive dhe konsultimeve publike, ku



prezenca e këshilltarëve ka qenë e vazhdueshme në bazë të zonës ku zhvillohet dhe tematikave të parashtruara. Pothuajse në të gjitha konsultimet, pavarësisht zonës ku zhvillohet apo problematikës/çështjes që diskutohet, Kryetari i Këshillit dhe sekretari kanë qenë gjithmonë prezent. Këta të dy janë në brendësi të procesit që në momentin kur vendoset në kalendrin e takimeve, gjatë procesit të njoftimeve e deri në zhvillimin e tij. Kjo praktikë dhe bashkëpunim njihet dhe vlerësohet po njësoj nga të gjithë.

Burimet e Këshillit Bashkiak


Pavarësisht suksesit që anketuesit e kanë shprehur në masën 100% për procesin e njoftimit dhe informimit, ata nuk ndajnë të njëjtin mendim për mjaftueshmërinë e burimeve në këtë proces. 43% e tyre janë shprehur se KB Fier nuk i ka burimet e nevojshme për realizimin e njoftimit dhe informimit të publikut dhe pjesa tjetër që këto burime nuk janë në dispozicion.



Instrumentat e KB për Njoftimin dhe Informimin e Publikut

Këshilli i Bashkisë Fier, përveç hapësirës së dedikuar në faqen zyrtare të Bashkisë <http://bashkiafier.gov.al/sq-al/Keshilli/Pages/default.aspx> ka dhe një faqe në rrjetet sociale, ku arrin njoftimin dhe informimin e publikut në një kohë më të shpejtë dhe efikase. Njoftimet dhe të gjitha informacionet publikohen në faqen e internetit të Këshillit Bashkiak dhe të Bashkisë Fier. Ato pasqyrohen me korrektësi duke përmbushur edhe afatet ligjore.

Këtu anketuesit kanë parasysh edhe njoftimet që kryhen për qytetarët gjatë zhvillimit të mbledhjeve të KB. Ato publikohen sipas Ligjit 5 ditë përpara bashkë me rendin e ditës që do të diskutohet dhe trajtohet nga këshilli. Në lidhje me konsultimet janë shprehur se pas publikimit të kalendarit janë respektuar edhe datat afatet dhe procedurat e procesit. Mënyrat më të përdorura sipas anketuesve dhe monitorimeve të bëra për procesin e njoftimit dhe informimit publik janë:





- 100% - Lajmërim në mediat sociale (Facebook, etj)
- 43% - Lajmërim publik afishuar në ambjentet e Bashkisë
- 28% - Lajmërim individuale përmes postës apo takimeve direkte




Regjistri Elektronik

Në lidhje me ekzistencën ose jo të një Regjistri Elektronik të publikuar dhe përditësuar rregullisht, anketuesit kanë dhënë mendime të ndryshme. 57% kanë deklaruar se ka një Regjistër Elektronik, 14% kanë thënë të kundërtën, kurse 29% që nuk e dinë.

Nga monitorimet e bëra edhe në faqen zyrtare të Bashkisë, në rubrikën Këshilli Bashkiak ku publikohen të gjitha aktet, njoftimet dhe çdo informacion tjetër që lidhet me këtë këshill, ka të publikuar një Regjistër Elektronik, por ai nuk përditësohet.



E njëjta situatë paraqitet edhe me Programin e Transparencës të Bashkisë Fier. 57% e të anketuarve kanë pohuar se Programi i Transparenës është hartuar dhe publikuar në faqen zyrtare, sikurse kanë pohuar që edhe përditësohet, kurse 43% kanë thënë të kundërtën. Ligji 119/2014 detyron autoritetet publike të përgatisin, përditësojnë dhe publikojnë PT, për të rritur transparencën dhe gamën e informimit.



Përsa i përket hartimit dhe publikimit të raporteve vjetore të punës së Këshillit për transparencën në procesin e vendimmarrjes përqindjet janë si mëposhtë:

- 72% nuk ka dhe nuk publikohen
- 28% ka dhe publikohen



Trajnimet në Lidhje me Detyrimet Ligjore dhe Informimin Publik

Referuar pyetjes për trajnimet e mundshme që këshilltarët kanë marrë pjesë në lidhje me detyrimet ligjore për informimin publik, 71% e tyre janë shprehur se nuk kanë marrë asnjë trajnim në lidhje me këtë çështje, kurse 29% kanë pohuar se kanë marrë pjesë.

Nga monitorimet e bëra dhe diskutimet jashtë intervistave të strukturuar jemi informuar se gjatë këtij viti shumë këshilltarët

janë ftuar të marrin pjesë në disa paketa trajnimesh në lidhje me të drejtën e informimit, njoftimit publik, mbi rëndësinë e tyre, etj, por vetëm një pjesë e vogël i janë përgjigjur pozitivisht me pjesëmarrje kësaj ftese.

Lidhur me nevojat për trajnim në të ardhmen në lidhje me informimin publik, njoftimin dhe konsultimin, anketuesit përgjithësisht kanë shprehur gatishmëri për çdo trajnim të mundshëm.





8. KONKLUZIONE

- Procesi i njoftimit, informimit dhe konsultimit publik, parimisht vlerësohet si shumë i rëndësishëm nga Bashki Fier dhe Këshilli Bashkiak Fier, që ndikon direkt në rritjen e transparencës dhe forcimin e bësimit të qytetarëve ndaj institucioneve publike.
- Ka një mungesë të theksuar informacioni (përveç atyre që kanë direkt lidhje me këtë proces) në lidhje me procesin e njoftimit dhe informimit publik si në stafin e Bashkisë Fier ashtu edhe në anëtarësinë e Këshillit Bashkiak.
- Faqja zyrtare e bashkisë Fier ka paralizuar këtë proces online, por në mënyrë manuale, nëpërmjet afishimeve në stendat e bashkisë, apo kthim përgjigje zyrtare ky proces rezulton i suksesshëm. Mungesën e funksionimit të faqes web e mbulon përkohësisht faqja zyrtare e bashkisë në media sociale FB.
- Në bashkinë Fier ka një koordinator për të drejtën e informimit dhe njoftimit por ata nuk mbulojnë vetëm këtë fushë.
- Bashkia Fier përdor të gjitha mënyrat online, në hapësirë dhe të drejtëpërdrejta për të njoftuar dhe informuar komunitetin.



9. REKOMANDIME

Përpjekjet e Bashkisë Fier për të krijuar një model transparent, me akses të gjerë të qytetarëve në informacione duket se do të vazhdojnë të jenë një sfidë. Më poshtë po rendisim disa rekomandime në lidhje me sa më sipër:

- Ndërtimi sa më shpejt i faqes së re zyrtare të Bashkisë Fier do të krijonte lehtësi për publikimin e informacioneve dhe njoftimeve për qytetarët, e cila do t'i shërbente dhe transparencës institucionale.
- Përdorimi i anketave për të matur kënaqësinë e qytetarëve në lidhje me nivelin e informimit, njoftimit dhe pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje.
- Praktikimi sa më shpesh i dëgjësive publike për t'i kthyer ato në procese ndikuese në komunitet, duke nxitur edhe rritjen e besimit.
- Zbatimi i Ligjit për konsultimin publik, njoftimet publike, dhe ndjekjen e procedurave për dëgjësat publike.
- Hartimi dhe publikimi i informacioneve dhe njoftimeve në mënyrë sa më të thjeshtë dhe të kuptueshme për të gjithë qytetarët.
- Nxitja e interaktivitetit mes anëtarëve të Këshillit Bashkiak.
- Ofrimi i një pakete të plotë trajnime për anëtarët e Këshillit Bashkiak por dhe për stafin e Bashkisë Fier, kryesht në lidhje me informimin publik, njoftimin dhe konsultimin.
- Standardizimi i faqes zyrtare (web) në mënyrë që çdo qytetar, kudo qoftë ai të di ku të kërkoj informacionet. Nëse faqet kanë të njëjtin model dhe strukturë përmbajtësore kushdo të hyjë në të e di ku të kërkojë informacionin.
- Sa më shumë trajnime dhe fushata ndërgjegjësuese mbi të drejtën e informimit.



Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.” Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec;
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan